



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë
Datë: 20.03.2023

REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA			
Sh. U.	13	Nr. Br.	9575
Nr. i faq.	3	Data:	20/03
Br. str.		Datum:	
KAMENICË/A 2023			

Bazuar në nenin 17, 18, 19, 20, dhe 21 të Rregullores Sh.01.Nr.31251 të datës 29.09.2022 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik dhe Diasporë shpall thirrjen publike për ndarjen e subvencioneve për bizneset e vogla dhe start-up:

THIRRJE PUBLIKE

Për mbështetjen e biznese të vogla dhe start up në zgjerimin e kapaciteteve prodhuese, përpunuese dhe shërbyese që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik lokal.

Shuma e përafërt e kësaj thirrje është 100,000.00€ (njëqind mijë euro).

Komuna e Kamenicës, shumën e fondit të vendosur në dispozicion për vitin 2023, do ta ndaj në dy kategori:

- LOT 1: Bizneset Start Up;
- LOT 2: Bizneset ekzistues, ndërmarrjet mikro dhe të vogla;
(me një qarkullim prej 500.00 € deri në 50,000.00€ nga viti i fundit kalendarik të dëshmuara nga ATK)

Çdo aplikacion i dorëzuar në këtë thirrje për mbështetje publike duhet të jetë brenda shumave vijuese minimale dhe maksimale:

Loti 1- Start-up

Nga 500.00 deri në 3,000.00 €;

Loti 2 Biznese ekzistuese - Ndërmarrjet mikro dhe të vogla

Nga 1,000.00€ deri në 5,000.00 €;

Përqindja e bashkëfinancimit nga aplikantët është obligative. Bashkëfinancimi i nevojshëm në kategorinë LOT 1 – Start – up, min 10%.

Bashkëfinancimi i nevojshëm në kategorinë LOT 2 – Biznese Ekzistuese, ndërmarrje mikro dhe të vogla, min 20%.

Kriteret për aplikim:

1. Të jetë biznes që operon në Komunën e Kamenicës, ku edhe do të bëhet investimi;
2. Në rast se është start-up, regjistrimi i biznesit bëhet pas shpalljes përfitues,
3. Bizneset duhet të jenë të regjistruara në Zyrën për Regjistrimin e Bizneseve në Komunën e Kamenicës
4. Të gjenerojë punësim me marrjen e grantit. Biznesi duhet të punësojë së paku një punonjës me marrjen e grantit. Punësimi i më tepër se një punonjësi për biznesin konsiderohet përparësi,
5. Përparësi kanë bizneset që udhëhiqen nga gratë, të rinjtë nën moshën 35 vjeçare si dhe komunitetet jo shumicë;
6. Bizneset duhet të kontribuojnë me vetëfinancim, me së paku 10% për bizneset start up dhe 20% për bizneset ekzistuese të vlerës së grantit të fituar.

Dokumentet e nevojshme për aplikim

1. Plotësimi i aplikacionit për bizneset Start UP; (Shtojca A)
2. Plotësimi i aplikacionit për bizneset ekzistuese; (Shtojca A_1)
3. Buxheti; (Shtojca B)
4. Plotësimi i aplikacionit për informata personale; (Shtojca B_1)
5. Deklarata e aplikantit; (Shtojca C)
6. Dokumenti identifikues personal valid të lëshuar nga Republika e Kosovës;
7. Certifikatë e vendbanimit (për persona fizik);
8. Certifikatën e regjistrimit të biznesit me të gjitha informatat përcjellëse sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës, certifikata duhet të jetë e re, lëshuar nga ARBK sipas numrit unik identifikues; (e aplikueshme për bizneset ekzistuese)
9. Dëshmi për pagesën e taksave komunale; (e aplikueshme për bizneset ekzistuese)
10. Dëshmi për pagesën e tatimit në pronë;
11. Vërtetim tatimor (*jo më i vjetër se data e shpalljes së thirrjes publike*) me të cilën vërtetohet se aplikuesi nuk ka borxhe aktuale tatimore të pashlyera apo obligime)
12. Oferta/Profatura për pajisjet/makineritë e planifikuara në projekt (*oferta duhet të përmbajë të dhëna të sakta të ofruesit në ofertë dhe të dhëna sakta të marrësit të ofertës, gjithashtu oferta nuk duhet të jetë më e vjetër se data e shpalljes së thirrjes për mbështetje*).

Vërejtje: Dokumentet e listuara më lartë duhet të jenë me dukshmëri të qartë. Dokumentet nga numri 1 deri në numrin 5, mund të shkarkohen në web faqen zyrtare të Komunës së Kamenicës.

Formularët e nevojshëm për plotësim: Stojca A, Stojca A_1, Stojca B, Stojca B_1, Stojca C mund të shkarkohen në ëeb faqen zyrtare të komunës së Kamenicës.

Afati i fundit për aplikim është 7 Prill 2023, në ora 16:00. Aplikacionet e kompletuara do të pranohen nga Qendrën për Shërbimet me Qytetarë.

Detajet e aplikimit mund ti gjeni të shtjelluara në udhëzuesin për aplikantët e granteve DZHED 2023 i cili është i bashkangjitur me të gjitha shtojcat e aplikimit.

Burbuqe Leka - Drejtore DZHED

